

UDHËZUES PËR MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RREZIQET E LIDHURA ME EKSPLOZIMIN NDAJ AZBESTIT NË VENDIN E PUNËS

Ky Udhëzues është përgatitur me qëllim të ofrimit të udhëzimeve të qarta dhe praktike për mbrojtjen e të punësuarve nga ekspozimi ndaj azbestit në vendin e punës. Azbesti përbën një rrezik serioz për shëndetin, prandaj parandalimi, identifikimi i rreziqeve dhe zbatimi i masave mbrojtëse, janë thelbësore për sigurimin e një ambienti të sigurt dhe të shëndetshëm pune.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstva za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobođilačke Borbe
Ministry of Labor, Family and Liberation War Values

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI.....	3
LEGJISLACIONI LIDHUR ME MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RREZIQET E LIDHURA ME EKSPOZIMIN NDAJ AZBESTIT NË VENDIN E PUNËS.....	4
DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË PUNËDHËNËSIT NË MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RREZIQET E LIDHURA ME EKSPOZIMIN NDAJ AZBESTIT.....	4
TRAJNIMI DHE INFORMIMI I TË PUNËSUARVE.....	13
PËRGJEGJËSITË DHE DETYRIMET E TË PUNËSUARVE NË LIDHJE ME EKSPOZIMIN NDAJ AZBESTIT.....	15
VLERËSIMI SHËNDETËSOR I TË PUNËSUARËVE.....	15
AUDITIMET.....	20
VËREJTJET.....	20
SHTOJCA1: SHEMBUJ TË FAKTORËVE TË RREZIKUT NGA EKSPOZIMI NDAJ AZBESTIT NË PUNË.....	20



HYRJE

Punëdhënësit kanë një rol kyç në krijimin e një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm për punëtorët e tyre. Përveç sigurimit të kushteve fizike të përshtatshme dhe pajisjeve të nevojshme për punë të sigurt, është thelbësore të menaxhohet ekspozimi ndaj azbestit, një substancë e rrezikshme që paraqet kërcënim serioz për shëndetin e njeriut, veçanërisht për sistemin respirator.

Ekspozimi i pakontrolluar ndaj azbestit mund të shkaktojë sëmundje të rënda dhe afatgjata, duke ndikuar drejtpërdrejt në shëndetin, mirëqenien dhe aftësinë për punë të të punësuarve. Prandaj, zbatimi i masave parandaluese dhe respektimi i kërkesave të rregullores për mbrojtjen nga rreziqet e ekspozimit ndaj azbestit, janë të domosdoshme për të reduktuar rrezikun dhe për të garantuar një ambient pune të sigurt.

Ky Udhëzues synon të ndihmojë punëdhënësit dhe punëtorët, duke ofruar informacione të qarta dhe praktike për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga azbesti në vendin e punës. Ai përfshin masa për parandalimin e ekspozimit, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, procedurat e sigurta të punës dhe zhvillimin e një kulture organizative që promovon sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë të punësuarëve.

FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky Udhëzues synon të përcaktojë masat minimale për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj azbestit në vendin e punës, duke u fokusuar në parandalimin e efekteve të dëmshme në shëndet, veçanërisht në sistemin respirator.

Ai zbatohet për të gjitha vendet dhe aktivitetet ku punëtorët, gjatë punës së tyre, janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj pluhurit që rrjedh nga azbesti ose nga materialet që përmbajnë azbest, pavarësisht natyrës së punës.

Qëllimi është që të ndihmojë në ndërtimin e një ambienti pune të sigurt dhe të shëndetshëm, ku punëtorët të jenë të mbrojtur nga rreziqet e lidhura me azbestin dhe ku menaxhimi i këtyre rreziqeve të mundësojë parandalimin e sëmundjeve dhe pasojave afatgjata në shëndet. Udhëzuesi inkurajon zhvillimin e një kulture organizative që favorizon identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e hershëm të rreziqeve, duke përfshirë përdorimin e masave teknike, organizative dhe personale të mbrojtjes.

Bazuar në praktikatat dhe standardet e rekomanduara për sigurinë dhe shëndetin në punë, ky Udhëzues thekson rëndësinë e masave parandaluese për përmirësimin e sigurisë, ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së punëtorëve në afat të gjatë kohor.



LEGJISLACIONI LIDHUR ME MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RREZIQET E LIDHURA ME EKSPOZIMIN NDAJ AZBESTIT NË VENDIN E PUNËS

Legjislacioni i mëposhtëm zbatohet dhe duhet të merret parasysh kur planifikoni çdo lloj aktiviteti lidhur me mbrojtjen e të punësuarëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në vendin e punës:

- **Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2013.**
Linku: (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>)
- **Rregullore MPMS, NR. 07/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në vendin e punës.**
Linku: (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15794>)
- **Direktiva: 2009/148/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 30 nëntor 2009 për mbrojtjen e të punësuarëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë.**
Linku: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:02009L0148-20190726>.
- **Direktiva (BE) 2023/2668 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 22 nëntorit 2023 që ndryshon Direktivën 2009/148/KE për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë.**
Linku: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=OJ:L_202302668

DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË PUNËDHËNËSIT NË MBROJTJEN E TË PUNËSUARVE NGA RREZIQET E LIDHURA ME EKSPOZIMIN NDAJ AZBESTIT NË VENDIN E PUNËS

Punëdhënësi ka përgjegjësi themelore për të garantuar mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj azbestit në vendin e punës. Në këtë kuadër, punëdhënësi është i obliguar që të:

1. kryejë vlerësimin e rrezikut për çdo aktivitet pune ku punëtorët janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj pluhurit që rrjedh nga azbesti ose materialet që përmbajnë azbest;
2. përcaktojë natyrën, nivelin dhe kohëzgjatjen e ekspozimit të punëtorëve ndaj azbestit;



3. vendosë dhe zbatojë masa teknike, organizative dhe mbrojtëse të nevojshme për të parandaluar ose zvogëluar ekspozimin dhe për të siguruar shëndetin e punëtorëve, duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në rregullore dhe shtojcat përkatëse;
4. sigurojë që të mos tejkalohen vlerat kufitare të ekspozimit ndaj azbestit në ajrin e ambientit të punës.

Në rastet kur ekspozimi është sporadik, me intensitet të ulët dhe vërtetohet nga vlerësimi i rrezikut se vlera kufitare nuk tejkalohet, punëdhënësi mund të zbatojë përjashtime të kufizuara nga disa kërkesa specifike, vetëm me miratimin e Autoritetit Kompetent dhe për aktivitete të caktuara, si:

1. punë të shkurtra dhe të përkohshme, mirëmbajtjeje me materiale jo të shkrufta;
2. heqje e materialeve fizikisht të padëmtuara, ku fibrat e azbestit janë të lidhura fort në matricë;
3. mbështjellje, izolim ose kapsulim i materialeve që përmbajnë azbest dhe janë në gjendje të mirë;
4. monitorim dhe kontroll i ajrit, si dhe marrje mostrash për të përcaktuar nëse një material përmban azbest.

Në përgjithësi, punëdhënësi duhet të sigurojë një qasje parandaluese dhe sistematike ndaj menaxhimit të rrezikut nga azbesti, duke bashkëpunuar me autoritetet kompetente dhe partnerët socialë, me qëllimin e mbrojtjes afatgjate të shëndetit të punëtorëve.

IDENTIFIKIMI I AZBESTIT DHE VLERËSIMI I RREZIKUT

Punëdhënësi nuk mund të marrë përsipër punime që e ekspozojnë apo ka gjasa që mund ta ekspozojnë punëtorin ndaj pluhurit që shkaktohet nga azbesti, vetëm në rastet kur:

1. ka kryer një vlerësim rrezikshmërie mbi prezencën apo mundësinë e prezencës së azbestit apo materialeve me përmbajtje azbesti në ato hapësira pune, ose
2. dyshohet se azbesti apo materialet me përmbajtje azbesti janë të pranishme në ato hapësira, si psh. Ka krijuar supozimin që azbesti apo materialet që përmbajnë azbest janë të pranishme.

Shembull praktik: Renovimi i një ndërtese të vjetër

Një kompani ndërtimi planifikon renovimin e një shkolle të ndërtuar para vitit 1990. Para fillimit të punës, duhet të:

- bëhet identifikimi i materialeve që mund të përmbajnë azbest;
- merren mostra dhe analizohen në laborator;
- përgatitet plan pune dhe të njoftohet autoriteti kompetent;
- izolohet zona dhe të vendosen shenja paralajmëruese;
- përdorin punëtorët respiratorë dhe veshje mbrojtëse.

☞ Pa këto masa, pluhuri i azbestit do të përhapej në ajër dhe do të rrezikonte punëtorët dhe përdoruesit e ndërtesës.



Përcaktimi dhe vlerësimi i rrezikshmërisë së ekspozimit ndaj azbestit

Duke mos anashkaluar nenin 16 të Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në rastet kur të punësuarit janë të ekspozuar apo kanë gjasa të jenë të ekspozuar ndaj pluhurit të azbestit ose nga materialet që përmbajnë azbest, atëherë punëdhënësi nuk duhet t'i lejojë punëtorët të kryejnë çdo lloj të tillë aktiviteti, vetëm në rastet kur ka bërë një vlerësim të rrezikut që lind nga një ekspozim i tillë. Gjatë kryerjes së vlerësimit të rrezikut punëdhënësi, duhet të ndërmarrë këta hapa:

1. Të identifikojë llojin e azbestit apo materialeve që përmbajnë azbest;
2. Të identifikojë gjendjen e azbestit apo materialeve me përmbajtje azbesti;
3. Të bëjë një vlerësim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm të rrezikut shëndetësor që ju shkaktohen të punësuarëve nga ekspozimi dhe të ndërmarrë hapa konkret drejt parandalimit apo zvogëlimit të ekspozimit ndaj azbestit, duke u bazuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (MPMS) nr. 07.2017 për mbrojtjen nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë;
4. Regjistrimin e gjetjeve të substancave gjatë vlerësimit të rrezikshmërisë, sa më parë që të jetë e mundur, pas kryerjes së vlerësimit të rrezikshmërisë;
5. Të ruajë dhe regjistrojë secilin vlerësim rreziku në një formë të përhershme.

Shembull: Mirëmbajtja industriale e tubacioneve të vjetra

Në një fabrikë zëvendësohen izolimet e vjetra të tubave që përmbajnë azbest. Atëherë duhet të:

- kufizohet numri i punëtorëve në zonë;
- hiqet materiali pa e thyer ose shpërndarë në pluhur;
- paketohen dhe etiketohen mbeturinat si mbetje me azbest;
- bëhet pastrim i kontrolluar i zonës së punës.

👉 Kjo parandalon shpërndarjen e fibrave mikroskopike në ajër.

Vlerësimi i rrezikut nga ekspozimi ndaj azbestit duhet të jetë i detajuar dhe gjithëpërfshirës, me qëllimin e identifikimit të natyrës dhe shkallës së ekspozimit, si dhe përcaktimin e masave të nevojshme për parandalimin ose uljen e rrezikut në nivelin më të ulët praktikisht të mundur.

Në veçanti, vlerësimi i rrezikut duhet të:

1. përcaktojë natyrën dhe shkallën e ekspozimit ndaj azbestit që mund të ndodhë gjatë punës;
2. marrë parasysh efektet e masave të kontrollit që janë zbatuar ose që do të zbatohen për të parandaluar ose reduktuar ekspozimin;
3. marrë parasysh rezultatet e monitorimit të ekspozimit në ajër;
4. përcaktojë hapat konkretë që duhet të ndërmerren për të parandaluar ekspozimin ose për ta ulur atë në nivelin më të ulët të arsyeshëm praktikisht;
5. marrë parasysh rezultatet e mbikëqyrjes mjekësore të punëtorëve;
6. përfshijë çdo informacion shtesë që punëdhënësi ka nevojë për ta përfunduar vlerësimin e rrezikut, në përputhje me Rregulloren (MPMS) nr. 07.2017 për mbrojtjen nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë.



Rishikimi i vlerësimit të rreziqeve duhet rishikuar rregullisht dhe paraprakisht, në rastet kur:

1. dyshohet se vlerësimi është i pasaktë;
2. ka arsye rreth dyshimeve mbi vlerësimin ekzistues se nuk është më i vlefshëm;
3. ka ndryshime të materialeve në aktivitetin për të cilin është bërë vlerësimi i rrezikshmërisë;
4. rezultatet e monitorimit të kryera tregojnë domosdoshmëri të rishikimit të vlerësimit të rrezikut;
5. punëdhënësi është i obliguar që të bëjë konsultë me të punësuarit apo përfaqësuesit e tyre çdo herë gjatë vlerësimit të rrezikshmërisë.

MASAT E PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME EKSPOZIMIN NDAJ AZBESTIT

Në çdo aktivitet ku punëtorët janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj azbestit, punëdhënësi duhet të zbatojë masa të përgjithshme teknike, organizative dhe higjienike, për të parandaluar ose reduktuar ekspozimin në nivelin më të ulët praktikisht të mundur.

Masat e përgjithshme të cilat duhet të ndërmerren punëdhënësi, janë:

1. Kufizimi maksimal i numrit të të punësuarëve të cilët janë apo me gjasë mund të ekspozohen ndaj pluhurit që shkaktohet nga azbesti, nga materialet që përmbajnë azbest apo nga të dyjat;
2. Të sigurohet që proceset dhe sistemet e punës të jenë të projektuara në atë mënyrë, që të mos prodhojnë pluhur azbesti. Në rastet kur kjo pamundësohet, atëherë të bëhet shmangia e lirim të azbestit në ajër;
3. Të sigurojë që vendet e punës dhe pajisjet të pastrohen dhe mirëmbahen rregullisht me metoda të përshtatshme;
4. Gjatë transportimit të materialeve që përmbajnë azbest, duhet të bëhet kujdes në ruheje dhe në paketim;
5. Mbeturinat që mblidhen duhet të hiqen nga vendi i punës sa më shpejt që të jetë e mundur, duke u paketuar kujdesshëm dhe duhet vendosur etiketa të cilat tregojnë se ka përmbajtje të azbestit, duke u bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ 221/2015 për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, përveç kur aktivitetet minerare kryhen në atë vend;
6. Duhet bërë shënjëmi i qartë, paralajmërimi për ndikimin e pluhurit të azbestit në ambientin e punës;
7. Duhet të sigurohet që të punësuarit të veshin veshmbathjet e përshtatshme për ambientin e punës, kur ekziston rreziku i ekspozimit ndaj pluhurit të azbestit;
8. Duhet të sigurohet që përveç këtyre punëtorëve që janë të obliguar t'i kryejnë detyrat e punës për të cilat janë angazhuar, nuk mund të kenë qasje punëtorë të tjerë;
9. Duhet të sigurohet që asnjë punëtor nuk do pijë duhan në ambientin e punës;
10. Në rastet kur ekspozimi ndaj azbestit nuk mundet të zvogëlohet me mënyra të tjera, atëherë duhet të sigurohen pajisjet e duhura mbrojtëse individuale për frymëmarrje, ku patjetër ato pajisje duhet të mbahen nga ata.

MATJA E AZBESTIT NË AJËR

Punëdhënësi duhet të sigurojë monitorimin e ekspozimit ndaj azbestit në ajër, në rastet kur ekziston ose mund të ekzistojë ekspozim, të ruajë rezultatet e matjeve dhe t'i përdorë ato për vlerësimin e rrezikut dhe përcaktimin e masave mbrojtëse, si dhe të informojë punëtorët për këto rezultate. Nga vlerësimet fillestare të bëra, në rast se niveli i fibrave të azbestit në ajër në një vend pune është i



barabartë apo më i lartë sesa vlera kufi e ekspozimit, atëherë është e detyrueshme që matja e azbestit të bëhet rregullisht.

Kur bëhet matja e azbestit në ajër, atëherë marrja e mostrave duhet të ketë parasysh:

1. Ekspozimin personal të punëtorit ndaj pluhurit që shkaktohet nga azbesti apo materialet me përmbajtje azbesti;
2. Marrjen e mostrave që duhet të bëhet nga një person kompetent, pas konsultimit të punëtorve apo përfaqësuesit të tyre nga ana e punëdhënësit;
3. Analizimi i mostrave të marra bëhet nga laboratorë të pajisur për numërimin e fibrave nga personi kompetent, numërim i cili duhet të bëhet në përputhshmëri me metodën PCM (mikroskop, fazë-kontrast), e rekomanduar nga OBSH (Organizata Botërore e Shëndetit) në vitin 1997. Ose me metodat e tjera që japin rezultate të ngjashme.
4. Kohëzgjatja e marrjes së mostrës duhet të merret për aq kohë sa të japë një pasqyrë reale të ekspozimit gjatë një ndërrimi tetëorësh.
5. Gjatë matjes së azbestit në ajër llogariten vetëm fibrat e gjata dhe të holla, sipas kriterëve të përcaktuara. (Gjatësi më e madhe se 5 mikrometra, gjerësinë më pak se 3 mikrometra si dhe raportin gjatësi/gjerësi më të madhe se 3:1).

Shembull praktik: Monitorimi i ajrit në vendin e punës

Në një kantier ekziston dyshimi për prani azbesti. Atëherë duhet të:

- merren mostra ajri gjatë një ndërrimi 8-orësh;
- bëhet analiza nga një laborator kompetent;
- Nëse vlera kufi tejkalohet, puna të ndalet menjëherë dhe të zbatohen masa korigjuese.

👉 Kjo siguron kontroll të vazhdueshëm të rrezikut real, jo vetëm teorik.

KËRKESAT PËR NJOFTIM DHE IDENTIFIKIMI I MATERIALEVE QË SUPOZOHEN TË PËRMBAJNË AZBEST

Punëdhënësi nuk duhet të ndërmarrë asnjë aktivitet që ekspozon ose mund të ekspozojë punëtorët ndaj pluhurit të shkaktuar nga azbesti ose materialet që përmbajnë azbest, përveç rasteve kur paraprakisht ka përgatitur një njoftim me shkrim.

Njoftimi me shkrim duhet t'i dorëzohet Autoritetit Kompetent, së bashku me një kopje të planit të punës sipas nenit 16, në mënyrë që të pranohet jo më pak se 14 ditë para fillimit të aktivitetit, ose brenda një periudhe më të shkurtër vetëm nëse kjo miratohet me shkrim nga Autoriteti Kompetent.

Në rast se, pas njoftimit fillestar, ndodh ndonjë ndryshim material në natyrën e punës ose në materialet që përmbajnë azbest dhe ky ndryshim mund të ndikojë në pikat e njoftuara (përfshirë edhe ndërprerjen e punës), punëdhënësi duhet ta njoftojë me shkrim Autoritetin Kompetent për këtë ndryshim. Për qëllimet e këtyre ndryshimeve, punëdhënësi duhet të paraqesë një njoftim të ri me shkrim, duke marrë parasysh ndryshimet e bëra dhe duke përfshirë arsyet për njoftimin e ri.



Punëdhënësi duhet të mbajë një kopje të çdo njoftimi dhe të çdo dokumenti tjetër dhe të sigurojë qasje në këto dokumente, në çdo kohë të arsyeshme, për:

- çdo punëtor të prekur nga njoftimi ose dokumenti, dhe
- çdo përfaqësues të punëtorëve për njoftimet ose dokumentet që kanë të bëjnë me vendin ose aktivitetin e punës së punëtorëve që ai përfaqëson.

Materialet që supozohen të përmbajnë azbest

Punëdhënësit duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të identifikuar materialet që supozohen të përmbajnë azbest në hapësirat ose vendet e punës, para fillimit të punimeve të rrënim, heqjes ose zhvillimit të punëve të mirëmbajtjes në këto hapësira ose vende pune.

Sipas nevojës, punëdhënësit duhet të sigurojnë informata në lidhje me identifikimin e këtyre materialeve nga pronarët e hapësirave ose vendeve të punës.

Nëse ekziston dyshimi për praninë e azbestit në ndonjë material ose konstruksion, atëherë duhet të zbatohen dispozitat përkatëse në Rregulloren (MPMS) Nr. 07/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë.

Masat që duhet të ndërmerren në rast të tejkalimit të vlerës kufitare të ekspozimit

1. Nëse gjatë kryerjes së punës punëtorët ekspozohen ndaj pluhurit që vjen nga azbesti ose materialet që përmbajnë azbest dhe si pasojë tejkalohet vlera kufitare e lejuar e ekspozimit, punëdhënësi është i obliguar të identifikojë shkaqet e këtij tejkalimi dhe të ndërmarrë pa vonesë masa korrigjuese për normalizimin e gjendjes.
2. Punëdhënësi duhet të sigurojë që aktivitetet e punës në zonën e ndikuar të mos vazhdojnë, derisa të zbatohen masa të përshtatshme për mbrojtjen e punëtorëve të ekspozuar.
3. Me qëllim të verifikimit të efektivitetit të masave të ndërmarra, punëdhënësi duhet të kryejë menjëherë matje shtesë për përcaktimin e përqendrimit të azbestit në ajër.
4. Në rastet kur ekspozimi nuk mund të reduktohet përmes masave të tjera teknike ose organizative dhe respektimi i vlerave kufitare kërkon përdorimin e pajisjeve personale për mbrojtjen e frymëmarrjes, përdorimi i këtyre pajisjeve duhet të jetë i përkohshëm dhe i kufizuar vetëm në minimumin e domosdoshëm për secilin punëtor.
5. Gjatë periudhave të punës kur kërkohet mbajtja e pajisjeve personale për mbrojtjen e frymëmarrjes, punëdhënësi, në konsultim me punëtorët përkatës dhe/ose përfaqësuesit e tyre, duhet të sigurojë pushime të rregullta në ambiente të përshtatshme, duke marrë parasysh kushtet fizike dhe klimatike të vendit të punës.

Masat specifike për disa aktivitete

Në rastet kur parashihet që si pasojë e aktiviteteve të caktuara si prishja, largimi, riparimi apo mirëmbajtja, përqendrimi i azbestit në ajër do të tejkalojë vlerën kufitare të ekspozimit, pavarësisht zbatimit të masave teknike parandaluese, punëdhënësi duhet që para fillimit të aktiviteteve, të përcaktojë dhe të zbatojë masa shtesë për mbrojtjen e punëtorëve gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve.

Masat shtesë që punëdhënësi duhet të zbatojë në këto raste janë:

1. Të pajisen punëtorët me mjete personale mbrojtëse të përshtatshme për mbrojtjen e frymëmarrjes dhe pajisje të tjera mbrojtëse, të cilat duhet të përdoren sipas udhëzimeve;
2. Duhet vendosur dhe mirëmbajtur shenja paralajmëruese të qarta dhe të lexueshme në dhe përreth zonave përkatëse të punës, të cilat tregojnë mundësinë e tejkalimit të vlerave kufitare të ekspozimit;
3. Të sigurohet që përhapja e pluhurit të shkaktuar nga azbesti ose materialet që përmbajnë azbest, të parandalohet jashtë objektit ose zonës ku zhvillohen aktivitetet e punës;
4. Të informohet çdo punëtor për detyrimet dhe përgjegjësitë e tij/saj;
5. Çdo punëtor ndaj të cilit zbatohen masat e përcaktuara të lartcekura, është i detyruar t'i respektojë dhe zbatojë të gjitha ato masa;
6. Punëdhënësi para se të ndërmarrë këto aktivitete, duhet të konsultohet me punëtorët e përfshirë dhe/ose përfaqësuesit e tyre lidhur me masat që do të zbatohen në kuadër të këtyre aktiviteteve.

Punimet e rrënimit

Para fillimit të punëve të rrënimit apo mirëmbajtjes, çdo punëdhënësi duhet ndërmarrë hapat e duhur duke marrë informatat nga pronarët e atyre hapësirave që do rrënohen, për të identifikuar materialet që supozohen që përmbajnë azbest. Nëse ka dyshim për praninë e azbestit atëherë duhet të zbatohen të gjitha dispozitat përkatëse të Direktivës 2009/148/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 30 nëntor 2009 për mbrojtjen e të punësuarëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë.



Shembull praktik: Ekspozim i lartë gjatë rrënimit

Gjatë prishjes së një objekti, konstatohet nivel i lartë pluhuri azbesti. Atëherë në këto raste duhet të ndërmarren këta hapa:

- Ndalohet puna në zonë;
- Identifikohet shkaku i tejkalimit;
- Vendosen masa shtesë mbrojtëse;
- Punëtorët përdorin respiratorë vetëm për periudhë të kufizuar;
- Organizohen pushime në ambiente të pastra.

🔒 Kjo mbron punëtorët nga ekspozimi akut.



Licencimi i punës me azbest

Punëdhënësi nuk mund të ndërmarrë punime me azbest nëse nuk merr licencën siç është e përcaktuar në Rregulloren (MPMS) Nr. 07/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë.

Autoriteti kompetent mund të japë licencën për punët me azbest, nëse aplikuesi i cili e kërkon licencën ka parashtruar kërkesë për licencim sipas specifikimeve më poshtë:

1. Plani i trajnimit dhe politika për të punësuarit që punojnë me materiale me përmbajtje azbesti;
2. Certifikata të trajnimit individual të të punësuarëve, e cila paraqet vendin, kohën, kohëzgjatjen dhe llojin e trajnimit të ofruar, si dhe ofruesin e trajnimit;
3. Përvoja relevante;
4. Deklarata e sigurisë;
5. Certifikata e rregullsisë së pjsjeve mbrojtëse për frymëmarrje për punëtorë individualë;
6. Certifikata mjekësore individuale e të punësuarëve;
7. Certifikata e spastrimit për njësinë e dekontaminimit që përdoret në vend (sipas llojit të punimit).

Riaplikimi bëhet së paku 28 ditë para datës së skadimit të licencës ose në një periudhë më të shkurtër që mund të caktohet nga Autoriteti Kompetent.

Licenca hyn në funksion në datën e specifikuar në licencë dhe ka vlefshmëri për një periudhë e cila specifikohet nga Autoriteti Kompetent, më së shumti 3 vjet dhe mund të jepet në pajtim me kushtet e përcaktuara nga Autoriteti Kompetent.

Autoriteti Kompetent mund të ndryshojë kushtet e licencës sipas kësaj Rregulloreje, nëse këtë e konsideron të përshtatshme edhe në veçanti mundet:

1. Të shtojë kushte të tjera, të ndryshojë apo të heqë ato ekzistuese;
2. Të shkurttojë periudhën e vlefshmërisë së licencës apo të zgjasë atë nga data kur është lëshuar licenca;
3. Autoriteti Kompetent mundet ta revokojë (shfuqizojë, anulojë) licencën, nëse e konsideron të domosdoshme;
4. Bartësi i licencës duhet t'ia kthejë licencën Autoritetit Kompetent, në rast se: Kërkohej nga vetë Autoriteti Kompetent apo pas revokimit të saj.

Sigurimi dhe pastrimi i veshmbathjes mbrojtëse

Punëdhënësi është i detyruar të parandalojë përhapjen e azbestit jashtë vendit të punës dhe të sigurojë trajtim të sigurt të çdo veshjeje të kontaminuar, për mbrojtjen e punëtorëve dhe mjedisit.

Në thelb, punëdhënësi duhet:

- Të sigurojë veshmbathje dhe pajisje mbrojtëse të përshtatshme për punëtorët që ekspozohen ndaj azbestit ose materialeve që përmbajnë azbest;
- Të sigurojë që veshjet e kontaminuara me pluhur azbesti të mos nxirren jashtë vendit të punës;

- Të kujdeset që veshjet mbrojtëse të pastrohen siç duhet ose të hidhen si mbetje azbesti, në mënyrë të sigurt dhe sipas procedurave përkatëse;
- Të sigurojë që pastrimi i veshjeve të bëhet në ambiente të pajisura posaçërisht për këtë qëllim ose në lavanderi të përshtatshme;
- Para se të largohen për pastrim ose asgjësim, veshjet e përdorura duhet të pakëtohen në mënyrë të sigurt dhe të etiketohen si materiale që përmbajnë azbest;
- Nëse për shkak të përdorimit të gabuar apo mosfunksionimit të veshjeve mbrojtëse azbesti kalon në rrobat personale të punëtorit, ato trajtohen njësoj si veshmbathje mbrojtëse (pra pastrohen ose asgjësohen sipas rregullave të njëjta).



Plani i punës

Në çdo kohë që planifikohet të ketë rrënim apo punime të tjera që përfshijnë heqjen, riparimin apo mirëmbajtjen e produkteve që kanë përbërje azbesti nga brendia e këtyre objekteve, punimet e tilla nuk mund të fillojnë deri në hartimin e një plani të përshtatshëm të punës me shkrim, i cili sqaron në mënyrë të detajuar se si do të kryhen këto punime.

Ky plan në vete duhet të specifikojë që: Azbesti, produktet me përmbajtje azbesti apo të dyja, duhen hequr aq sa është praktikisht e arsyeshme, para se të të aplikohen teknikat e rrënimit apo para se të fillojë ndonjë renovim madhor i hapësirave, përveç nëse shkaktojnë rrezik më të madh për punëtorë sesa nëse azbesti apo ato produkte që përmbajnë azbest do të lireshin në atë vend.

Plani duhet të përfshijë, së paku, elementet në vijim:

Përshkrimi i punimeve: lloji i aktivitetit që do të kryhet; vendndodhja e punimeve; materialet që përmbajnë azbest dhe mënyra e trajtimit të tyre.

Metodat e punës: procedurat e përdorura për trajtimin, heqjen ose izolimin e materialeve që përmbajnë azbest; teknikat që kufizojnë çlirimin dhe përhapjen e fibrave në ajër.

Masat mbrojtëse për punëtorët: përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale, organizimi i zonave të punës dhe kontrolli i aksesit, masat për higjienë dhe dekontaminim.

Monitorimi dhe kontrolli i ekspozimit: mënyra e kontrollit të koncentrit të azbestit në ajër dhe procedurat për verifikimin e efektivitetit të masave mbrojtëse.

Menaxhimi i mbetjeve: paketimi, etiketimi dhe transporti i mbetjeve që përmbajnë azbest dhe mënyra e asgjësimit sipas kërkesave ligjore.

Pastrimi dhe përfundimi i punimeve: pastrimi i zonës së punës, kontrolli përfundimtar i sigurisë dhe rikthimi i zonës në përdorim të sigurt.



Punëdhënësi duhet të sigurojë që të gjitha masat e parashikuara në plan të zbatohen në praktikë dhe që punëtorët të jenë të informuar për procedurat dhe detyrimet e tyre gjatë kryerjes së punës. Plan i punës garanton që çdo aktivitet me azbest të realizohet në mënyrë të planifikuar, të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë.

TRAJNIMI DHE INFORMIMI I TË PUNËSUARVE

Punëdhënësi duhet të sigurojë që të gjithë punëtorët që janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj azbestit, të marrin trajnim dhe informim të përshtatshëm, të mjaftueshëm dhe të rregullt, lidhur me rreziqet që lidhen me këtë ekspozim. Ky trajnim duhet të jetë i kuptueshëm, praktik dhe i përshtatur me natyrën e punës që kryhet.

Trajnimi duhet të përfshijë, në veçanti:

1. Vetitë e azbestit dhe efektet në shëndet

Punëtorët duhet të informohen për: çfarë është azbesti dhe ku mund të gjendet, mënyra se si fibrat e azbestit hyjnë në organizëm, sëmundjet që lidhen me ekspozimin (p.sh. sëmundjet e mushkërive dhe kanceret profesionale), faktin që efektet shëndetësore mund të shfaqen pas shumë vitesh, si dhe rritjen e rrezikut në kombinim me faktorë të tjerë, si duhani.

2. Burimet dhe situatat e ekspozimit

Punëtorët duhet të njohin: materialet që përmbajnë azbest, proceset dhe aktivitetet që mund të çlirojnë fibra në ajër dhe situatat kur rreziku është më i lartë (prishje, prerje, shpime, heqje materiale, etj.).

3. Praktikat e sigurta të punës

Trajnimi duhet të përfshijë: metodat e punës që minimizojnë lirimin e fibrave, procedurat e kontrollit teknik dhe organizativ, kufizimin e përhapjes së pluhurit dhe rregullat për pastrim dhe mirëmbajtje të sigurt.

4. Pajisjet Mbrojtëse Personale (PMP)

Punëtorët duhet të trajnohen për: llojet e pajisjeve mbrojtëse që duhet të përdoren, mënyrën e përdorimit korrekt dhe mirëmbajtjes së tyre, vendosjen dhe heqjen e sigurt të pajisjeve, si dhe kufizimet dhe rëndësinë e përdorimit të vazhdueshëm të tyre.





5. Masat higjienike

Trajnimi duhet të mbulojë: higjienën personale gjatë dhe pas punës, shmangien e kontaminimit të rrobave dhe ambienteve, procedurat për ndërrimin e veshjeve dhe pastrimin personal, si dhe parandalimin e transportimit të fibrave jashtë vendit të punës.

6. Procedurat emergjente

Punëtorët duhet të dinë: si të veprojnë në rast të çlirimit të pakontrolluar të fibrave, si të raportojnë menjëherë situatat e rrezikshme dhe masat e menjëhershme për mbrojtjen personale dhe kolektive.

7. Trajtimi dhe asgjësimi i materialeve që përmbajnë azbest

Trajtimi duhet të përfshijë: mënyrat e sigurta të mbledhjes dhe paketimit, transportimin dhe depozitimin e kontrolluar, po ashtu edhe rregullat për asgjësim sipas kërkesave ligjore.

Informimi i vazhdueshëm i punëtorëve

Punëtorët duhet të informohen rregullisht për: rezultatet e matjeve të ekspozimit në vendin e punës, vlerat kufitare të lejuara të ekspozimit, ndryshimet në procedura, pajisje ose organizimin e punës, çdo rrezik të ri të identifikuar. Informimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i aksesueshëm për të gjithë punëtorët.

Periodiciteti dhe përditësimi i trajnimit

Trajnimi nuk duhet të jetë një veprim i vetëm. Ai duhet të organizohet para fillimit të punës me rrezik ekspozimi, të përsëritet periodikisht dhe të përditësohet sa herë që ndryshojnë kushtet e punës, proceset, pajisjet ose niveli i rrezikut.

Përgjegjësia e punëdhënësit

Punëdhënësi duhet të sigurojë që: trajnimi të jetë cilësor dhe i dokumentuar, të gjithë punëtorët përkatës të përfshihen në trajnim, përmbajtja e trajnimit të jetë e përditësuar dhe punëtorët të kuptojnë dhe zbatojnë masat e mësuara.

Rëndësia e ndërgjegjësimit

Trajnimi dhe informimi nuk synojnë vetëm përmbushjen e detyrimeve ligjore, por krijimin e një kulture të sigurisë në vendin e punës. Punëtorët e informuar dhe të trajnuar mirë, janë faktor kyç në parandalimin e ekspozimit dhe në mbrojtjen afatgjatë të shëndetit. Punëdhënësi duhet të sigurojë që trajnimi të përsëritet periodikisht dhe të përditësohet sa herë që ndryshojnë kushtet e punës, proceset, pajisjet ose kur paraqiten rreziqe të reja. Gjithashtu, punëtorët duhet të informohen për rezultatet e matjeve të ekspozimit, për vlerat kufitare të lejuara dhe për rëndësinë e respektimit të masave mbrojtëse të përcaktuara.



PËRGJEGJËSITË DHE DETYRIMET E TË PUNËSUARVE NË LIDHJE ME EKSPOZIMIN NDAJ AZBESTIT

Përgjegjësia kryesore bie mbi punëdhënësin për organizimin e masave mbrojtëse ndaj azbestit. Mbrojtja efektive nga azbesti kërkon pjesëmarrje aktive dhe respektim të plotë të rregullave edhe nga të punësuarit. Detyrimet e tyre burojnë nga kërkesat për zbatimin e masave mbrojtëse, përdorimin e pajisjeve, respektimin e procedurave të punës dhe pjesëmarrjen në trajnim.

1. Zbatimi i masave parandaluese dhe procedurave të punës

Të punësuarit duhet të respektojnë të gjitha masat teknike dhe organizative të vendosura për të kufizuar ekspozimin ndaj azbestit, si dhe të zbatojnë metodat e sigurta të punës të përcaktuara në vendin e punës dhe në planin e punës.

2. Përdorimi korrekt i pajisjeve mbrojtëse personale

Punëtorët janë të obliguar të përdorin pajisjet mbrojtëse personale dhe pajisjet e kontrollit të ekspozimit sipas udhëzimeve dhe të mos ndërhyjnë në funksionimin e tyre.

3. Respektimi i rregullave të higjienës dhe kontrollit të kontaminimit

Punëtorët duhet të zbatojnë kërkesat higjienike për të parandaluar përhapjen e fibrave të azbestit, përfshirë përdorimin e hapësirave të caktuara për ndërrim, pastrim dhe shmangien e kontaminimit të veshjeve ose ambienteve të tjera.

4. Respektimi i masave në rast tejkalimi të vlerave kufitare

Nëse konstatohet tejkalim i kufijve të ekspozimit, punëtorët duhet të zbatojnë menjëherë masat korrigjuese dhe udhëzimet e dhëna për reduktimin e rrezikut dhe mbrojtjen e shëndetit.

5. Pjesëmarrja në trajnim dhe respektimi i udhëzimeve të sigurisë

Të punësuarit duhet të marrin pjesë në trajnimet e organizuara dhe të zbatojnë njohuritë dhe udhëzimet e marra lidhur me rreziqet e azbestit dhe mënyrat e mbrojtjes.

6. Bashkëpunimi në zbatimin e planit të punës dhe masave mbrojtëse

Punëtorët duhet të bashkëpunojnë në zbatimin e planit të punës, të ndjekin procedurat e përcaktuara dhe të mos kryejnë veprime që mund të rrisin rrezikun e ekspozimit.

Andaj, zbatimi real i mbrojtjes nga rreziqet e azbestit nuk varet vetëm nga organizimi i punës dhe masat e vendosura, por edhe nga sjellja dhe përgjegjësia individuale e çdo punëtori. Në këtë kuptim, roli i të punësuarve është thelbësor për funksionimin praktik të sistemit të mbrojtjes.



Punëtorët duhet të veprojnë me kujdes të shtuar në çdo aktivitet ku ekziston mundësia e kontaktit me azbestin, duke respektuar rregullat e punës së sigurt dhe duke përdorur mjetet mbrojtëse në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë. Ata duhet të ndjekin udhëzimet e dhëna, të zbatojnë njohuritë e fituara gjatë trajnimit dhe të kontribuojnë në ruajtjen e kushteve të sigurta të punës.

Një pjesë e rëndësishme e përgjegjësisë së tyre është edhe reagimi i menjëhershëm ndaj çdo situatë të pasigurt, duke raportuar rreziqet dhe duke shmangur veprimet që mund të rrisin ekspozimin ose të përhapin kontaminimin.

Në thelb, mbrojtja nga azbesti kërkon që çdo punëtor të jetë i vetëdijshëm, i kujdesshëm dhe bashkëpunues, duke e konsideruar sigurinë jo vetëm si detyrim formal, por si pjesë të pandashme të mënyrës së punës së përditshme. Vetëm përmes kësaj qasjeje mund të sigurohet mbrojtje reale dhe e qëndrueshme e shëndetit në vendin e punës.

Shembull praktik: Detyrimet e punëtorëve

Një punëtor i cili refuzon të përdorë maskën mbrojtëse.

- punëtori është i detyruar të zbatojë masat mbrojtëse,
- mosrespektimi përbën rrezik për shëndetin e vet dhe të të tjerëve.

Gjatë punës me materiale që përmbajnë azbest, punëtori përdor respiratorin dhe veshjen mbrojtëse sipas udhëzimeve, respekton procedurat e punës dhe raporton menjëherë çdo rrezik ose pajisje të dëmtuar të përgjegjësi i sigurisë. Kështu sigurohet mbrojtja e tij dhe parandalimi i përhapjes së kontaminimit.

👉 Pra, siguria është përgjegjësi e përbashkët.

VLERËSIMI SHËNDETËSOR I TË PUNËSUARËVE

Para çdo angazhimi të të punësuarëve në aktivitete në një vend pune ku ata i ekspozohen apo ka gjasa që gjatë punës së tyre i ekspozohen pluhurit që shkaktohet nga azbesti apo materialet me përmbajtje azbesti, atëherë punëdhënësi duhet t'i sigurojë që secilit punëtor t'i bëhet vlerësimi i shëndetit të tij.

Vlerësimi shëndetësor bëhet:

1. Para ekspozimit ndaj pluhurit që shkaktohet nga azbesti apo materialet me përmbajtje azbesti në vendin e punës dhe përfshijnë një ekzaminim të gjoksit. Ky ekzaminim duhet të jetë specifik.





2. Kurdo që ekspozimi ose ndonjë ekspozim të mundshëm (me apo pa ndërprerje) që i ka ndodhur një punëtori, e që ky ekspozim vazhdon për një periudhë kohore të punës, së paku për një periudhë prej tri vitesh.

Nëse ekspozimi vjen në shprehje në këto dy situata, atëherë punëdhënësi është i detyruar që të:

- sigurojë angazhimin e kontrollit shëndetësor të duhur dhe të përshtatshëm për çdo punëtor;
- ofrojë të dhëna të sakta, njoftim të duhur dhe në kohë të duhur lidhur me kontrollet shëndetësore, pasi që në këtë mënyrë punëtorët do të mund të respektojnë orarin e caktuar;
- ofrojë mundësi për mjekim, në këtë mënyrë ai do të njoftohet me kushtet e ekspozimit për secilin punëtor në vendin e punës.

Çdo punëtor duhet t'i ofrojë mjekut në fjalë, informatat për historikun e tij mjekësor, ashtu siç kërkohet nga mjeku, sepse në atë mënyrë bëhet vlerësimi i duhur.

Çdo punëtor i nënshtrohet testimeve të tilla që konsiderohen të domosdoshme nga mjeku për të siguruar kryerjen e vlerësimit mjekësor.

T'i nënshtrohet testimeve që konsiderohen të domosdoshme nga mjeku për të siguruar kryerjen e vlerësimit, ngase njohuritë e sotme tregojnë që ekspozimi ndaj fibrave të lira të azbestit mund të jetë shkaktar i këtyre sëmundjeve: 1. Azbestoza; 2. Mezotelioma; 3. Karcinoma bronkiale; 4. Karcinoma gastro-intestinale.

Vlerësimi shëndetësor i çdo punëtori bëhet pas intervistimit mjekësor dhe vizitës mjekësore të punëtorit, duke u bazuar në parimet dhe praktikën e mjekësisë punës, si dhe pas testeve që i bëhen punëtorit me kërkesën e mjekut.

Pas përfundimit të vlerësimit shëndetësor të një punëtori, mjeku këshillon apo përcakton masat mbrojtëse apo parandaluese individuale që duhet të ndërmerren kurdo që është e nevojshme, e që mund të përfshijnë po ashtu tërheqjen e punëtorit nga ekspozimi ndaj azbestit.

Mjeku duhet të shënojë në regjistrin e mjekësisë së punës nëse punëtori është i aftë, i paaftë apo i aftë me kufizime të caktuara për të kryer punë në vendin e punës, në vendin ku ka ekspozim ndaj fibrave të azbestit në ajër, vlera e të cilit nuk tejkalon vlerën kufitare të ekspozimit.

Mjeku përgjegjës, pas vlerësimit shëndetësor mund të rekomandojë që mbikëqyrja shëndetësore të vazhdojë edhe pas përfundimit të ekspozimit, aq kohë sa konsiderohet e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin e punëtorit në fjalë.

Kur punëtori apo punëdhënësi nuk pajtohet me rekomandimet mjekësore të dhëna nga mjeku përgjegjës pas vlerësimit mjekësor, mund të bëjë kërkesë për të rishikuar vlerësimin dhe rekomandimin e dhënë.



Dosjet mjekësore në lidhje me vlerësimet shëndetësore

Dosjet mjekësore individuale në lidhje me vlerësimet mjekësore të shëndetit të të punësuarëve, duhet të mbahen nga mjeku dhe duhet të përfshijnë këto informata:

1. Emri dhe adresa personale e punëtorit në fjalë;
2. Emri i punëdhënësit në fjalë, si dhe adresa apo adresat përkatëse;
3. Data e lindjes së punëtorit;
4. Data e fillimit të ekspozimit ndaj azbestit (nëse dihet);
5. Historia mjekësore e punëtorit;
6. Historia profesionale e punëtorit;
7. Rezultatet nga mostrat e marra që ndërlidhen me ekspozimin e punëtorit ndaj azbestit, të cilat kanë të bëjnë me ekspozimin e punëtorit;
8. Hollësitë e veprimeve të ndërmarra nga mjeku përkatës pas rezultateve të vlerësimit shëndetësor.¹

Dosjet mjekësore të secilit punëtor apo kopjet e tyre duhen mirëmbajtur nga mjeku përkatës për 40 vjet pas vlerësimit të fundit në ato dosje, për qëllimet e Rregullores (MPMS) Nr. 07/2017 për mbrojtjen e të punësuarëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë.

Kur për qëllimet e Rregullores së lartëcekur është e domosdoshme në çdo kohë, që të transferohen dosjet ekzistuese mjekësore te një person që është bërë mjek përgjegjës, ato duhet të transferohen nga njëri mjek te tjetri, apo kur rrethanat e kërkojnë nga përfaqësuesi personal i të punësuarit.

Kur kemi raste të ndonjë mosmarrëveshjeje apo ndonjë vështirësie që lind në lidhje me mënyrën e mirëmbajtjes apo transferimit të dosjeve mjekësore, atëherë për këtë çështje vendos Autoriteti Kompetent, i cili është i përcaktuar nga Qeveria dhe ai vendim do të ketë efekt juridik.

Zbulimi i informative që mbahen në vlerësimin shëndetësor

Punëtori, pasi t'i japë mjekut njoftim paraprak brenda një periudhe të arsyeshme (deri në 15 ditë), ka të drejtë të ketë qasje në informacionet që përmbahen në dokumentacionin e tij mjekësor. Mjeku është i obliguar ta sigurojë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me këto qëllime.

Në rast kur gjendja shëndetësore e punëtorit vlerësohet, në çdo kohë pas përfundimit të ekspozimit ndaj azbestit, mjeku përkatës duhet t'i ofrojë punëtorit informacionet dhe këshillat përkatëse lidhur me rezultatet e këtij vlerësimi. Kjo vlen edhe për ish punëtorët.

Regjistri i shëndetit profesional të të punësuarëve

Për çdo të punësuar që ekspozohet ndaj azbestit, duhet të mbahet një regjistër individual i shëndetit profesional.

¹ Rregullore (MPMS) Nr. 07/2017 për mbrojtjen e të punësuarëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë, f. 52.



Regjistri përmban të dhëna për: ekspozimin ndaj azbestit, rezultatet e ekzaminimeve mjekësore dhe mbikëqyrjes shëndetësore, çdo informacion relevant për gjendjen shëndetësore që lidhet me ekspozimin.

Këto të dhëna duhet të ruhen për një periudhë të gjatë kohore edhe pas përfundimit të ekspozimit, për shkak se sëmundjet nga azbesti mund të shfaqen shumë vite më vonë.

Regjistri duhet të jetë i qasshëm për autoritetet kompetente dhe për vetë punëtorin, duke respektuar rregullat e konfidencialitetit të të dhënave shëndetësore.

Nëse ndërmarrja mbyllet ose pushon aktivitetin, dokumentacioni duhet të ruhet dhe t'i dorëzohet Autoritetit Kompetent sipas rregullave.

Ndalimi i përdorimit dhe trajtimit të azbestit

Ndalohet përdorimi i azbestit përmes proceseve të spërkatjes dhe përdorimi i materialeve izoluese me densitet të ulët ose materialeve akustike që përmbajnë azbest.

Ndalohet çdo aktivitet që ekspozon punëtorët ndaj fibrave të azbestit gjatë nxjerrjes, prodhimit dhe përpunimit të azbestit ose produkteve që përmbajnë azbest të shtuar qëllimisht.

Përjashtim bëhet vetëm për trajtimin dhe depozitimin e produkteve që dalin nga punimet e rrënimit dhe heqjes së azbestit.

PËRFUNDIMI

Ky Udhëzues paraqet një dokument themelor orientues, për garantimin e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj azbestit në vendin e punës. Përmes përcaktimit të qartë të detyrimeve, procedurave parandaluese dhe masave mbrojtëse, ai krijon një kornizë të strukturuar për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rrezikut, duke siguruar që aktivitetet profesionale të zhvillohen në kushte të sigurt dhe të kontrolluara.

Në thelb, Udhëzuesi thekson se menaxhimi i rrezikut nga azbesti nuk është vetëm një kërkesë ligjore, por një përgjegjësi e drejtpërdrejtë institucionale dhe profesionale që lidhet me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëtorëve. Zbatimi sistematik i masave parandaluese, monitorimi i vazhdueshëm i ekspozimit dhe përdorimi korrekt i pajisjeve mbrojtëse personale janë elemente kyçe për reduktimin e rrezikut dhe parandalimin e sëmundjeve profesionale afatgjata.

Udhëzuesi gjithashtu kontribon në ndërtimin e një kulture organizative të sigurisë, ku parandalimi trajtohet si prioritet strategjik dhe ku çdo nivel i strukturës organizative merr pjesë aktive në menaxhimin e rrezikut. Ai nxit përgjegjshmëri, transparencë dhe bashkëpunim ndërmjet punëdhënësve dhe punëtorëve, duke e bërë sigurinë një proces të vazhdueshëm dhe të integruar në praktikën e përditshme të punës.

Në aspekt institucional, zbatimi i këtij Udhëzuesi siguron përputhshmëri me standardet dhe kërkesat rregullative, përmirëson menaxhimin e rrezikut profesional dhe forcon kapacitetet organizative për



reagim të sigurt dhe të kontrolluar ndaj çdo situatë, që lidhet me praninë ose trajtimin e materialeve që përmbajnë azbest.

Në përfundim, ky Udhëzues shërben si një instrument praktik dhe strategjik për mbrojtjen e shëndetit në punë, duke kontribuar në parandalimin e dëmtimeve profesionale, ruajtjen e mirëqenies së punëtorëve dhe sigurimin e një mjedisi pune të qëndrueshëm, të kontrolluar dhe të përgjegjshëm.

AUDITIME

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetëinspektime, sipas listës së sugjeruar në Shtojcë. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive sigurinë dhe shëndetin në punë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm, siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës, etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Mbani mend: Rreziqet ndaj azbestit në punë mund të gjenden në të gjitha llojet e vendeve të punës. Ju mund të zvogëloni ose eliminoni rreziqet duke i identifikuar ato, duke vendosur masa të përshtatshme kontrolli për të mbajtur të sigurt punëtorët tuaj, duke komunikuar me ta dhe duke i mbështetur ata.

SHTOJCA1: SHEMBUJ TË FAKTORËVE TË RREZIKUT NGA EKSPOZIMI NDAJ AZBESTIT NË PUNË

Si pjesë e procesit të vlerësimit të riskut të ekspozimit ndaj azbestit, do të jetë e nevojshme të identifikohen faktorët e rrezikut që janë të rëndësishëm për një detyrë të veçantë. Informacioni i mbledhur më pas, mund të përdoret për të identifikuar se çfarë përmirësimesh mund të vendosen për të mënjeluar ose zvogëluar ekspozimin ndaj azbestit.

FAKTORËT E RREZIKUT	PO	JO	KOMENT
A e keni identifikuar praninë, vendndodhjen dhe sasinë e të gjitha materialeve që përmbajnë azbest në vendin e punës?			
A janë informuar të punësuarit për të gjitha materialet që përmbajnë azbest në zonat e tyre përkatëse të punës? A janë vendosur shenjat dhe etiketat që identifikojnë azbestin në mënyrë që të gjithë të punësuarit të dinë t'i shmangin këto materiale?			
A janë punëtorët të pajisur me një dhomë të pastër dhe ambiente dushi të përshtatshme për punën që po kryhet, dhe a është ndaras			



zhveshtorja nga zona e ruajtjes ku ruhen veshjet dhe pajisjet potencialisht të kontaminuara?			
A janë vendosur shenja paralajmëruese dhe të sigurisë në zonën ku përdoret azbesti? A janë të lexueshme lehtë? A janë shënuar qartë zonat/detyrat e përcaktuara për përdorim të PPM-ve?			
Pirja e duhanit, ngrënia e çamçakëzit, dhe aplikimi i kozmetikës duhet të ndalohet në zonën e rregulluar.			
A është ndaluar pirja e duhanit në të gjitha zonat e punës?			
Kërkoni nga të punësuarit t'i lajnë duart, fytyrën, parakrahët dhe qafën para çdo dalje nga zona e demarkuar dhe të bëjnë dush në fund të ditës. Sigurohuni që ata i ndjekin udhëzimet.			
Të punësuarve duhet t'ju sigurohen veshje mbrojtëse për tërë trupin para se të hyjnë në zona të demarkuara.			
A i zhveshin të punësuarit veshjet mbrojtëse kur largohen nga zonat e demarkuara? Në fund të ditës, a i vendosin ato veshje në një kontejner të padepërtueshëm për dekontaminim ose asgjësim?			
Duhet të ofrohen vende të ndara të ruajtjes për veshjet e punës ose mbrojtëse dhe për veshjet normale.			
Kontrollet inxhinierike duhet të përdoren për të zvogëluar ekspozimin ndaj azbestit të të punësuarve në nivelet më të ulëta të arritshme, dhe ventilimi lokal i shkarkimit duhet të projektohet, ndërtohet, instalohet dhe mirëmbahet.			
Të gjitha pajisjet e dorës dhe makineritë që mund të prodhojnë ose lëshojnë fibra azbesti, duhet të pajisen me ventilim lokal shkarkimi.			
Duhet të merret një autorizim nga Autoriteti Kompetent, për të punuar me materiale që përmbajnë azbest. Mbajtësi i licencës duhet të ketë sisteme të instaluar për dekontaminimin dhe mirëmbajtjen vjetore të pastruesve me vakum të azbestit të Klasit H.			
A e mbani ju si punëdhënës licencën e saktë për punën që po ndërmerret?			
Të punësuarit duhet të trajnohen për punën me azbest dhe ACM. Ata duhet të kenë certifikata individuale të trajnimit të të punësuarve.			
Sigurohuni që është bërë vlerësimi i riskut.			



A e keni regjistruar numrin dhe emrat e të punësuarve potencialisht të ekspozuar ndaj azbestit?			
Organizoni matjen e fibrave të azbestit në ajrin e vendit të punës. Sigurohuni që të parandalohet ekspozimi i tepërt i të punësuarve ndaj azbestit (mbi 0.1 fibra për centimetër kub (ff/cm ³) të ajrit në 8 orë, mesatarja e ponderuar në kohë (TWA)).			
Të punësuarit duhet të dërgohen në kontrolla të detyrueshme shëndetësore në intervale të rregullta.			